



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 29.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **23.08.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Atom Med O.P**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së”** LOT 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30, me numër prokurimi **206-23-4215-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Atom Med O.P e dt.12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” Lot 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 16.04.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. **Mbeten në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 21.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon tutje me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Atom Med O.P me datë 23.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” – Lot 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE Atom Med O.P:

Nuk ka specifikuar ndonje dispozite të shkelur.

Pretendimet ankimore:

Me daten 21.08.2023 permes platformes elektronike kemi marr njoftimin B42 nga AK per eliminimin e AtomMed nga Llotet 21,22,23,24,25,26,27,28,29, dhe 30 me pretendime se Broshurat e bashkangjitura kan qene te modifikuara.

Arsyeja se keni kerkuar ne webfaqen e prodhuesit dhe nuk keni arritur ti gjeni broshurën dhe detajet qe keni kerkuar, dhe ka mjaftua me kaq kerkimet e juaja, eshte vendim i ngutshem nga ana e AK.

Katalog un dhe specifika jan derguar nga Prodhuesi "Alvi Expo", duke i bashkangjitur per secilin produkt te ofruar edhe foto te produkteve , dhe secili katalog eshte i nënshkruar nga vete prodhuesi , dhe prodhuesi ka ofruar edhe detajet e kontaktit te cilat ju mundeni ta kontaktoni vet prodhuesin per katalogun te cilen e ka derguar , per kete arsye edhe eshte kerkuar kontaktet e prodhuesit qe te kontaktohet per qfardo pyetje apo paqartesia qe ju nevojitet, duke ja u lehtesuar edhe juve si AK per qfardo paqartesia qe keni!

Ju si AK duhet ta kuptoni se nje kompani prodhuese e Instrumenteve mjeksore mundet edhe te mos i perfshije te gjitha produktet e saja ne webfaqen e tyre per arsye dhe qëllime te tyre dhe eshte me se normale. Asnje kompani, nuk publikon te gjitha produktet ne detaje se qfare shet, apo ofron, jane plotika te saja.

Ju lutem ta vlersoni edhe njehere oferten tone, dhe ta keni per baze broshuren te cilen e ka derguar prodhuesi te nenshkruar ,dhe ta kontaktoni per çfardo paqartesia apo dyshimi qe keni.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE

Refuzohen pretendimet ankimore te OE Atom Med O.P.

Bazuar në kriterin e DT te Kapaciteti teknik dhe professional, pika 9.1 & 9.2 është kerkuar:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nenvizohen ne menyre te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara. Nëse ofrohet broshura, duhet te specifikohet linku i veb faqes.

Kuptohet qartë nga kërkesa e mësipërme është kërkuar katalogu ose broshura nga prodhuesi, dhe të NËNVIZOHEN modelet si dhe specifikat e pajisjeve te ofruara, komision vlerësues gjatë vlerësimit ka aluduar se katalogu përmban saktësisht specifikat teknike të DT-së, kjo dukuri mund të vërehet pasi që specifikat teknike të katalogu janë 100% të njëjta e që aludojmë se janë kopjuara nga DT, si dhe renditja e produkteve është e një pas njëshme edhe pse produktet nuk janë të familjes së njëjtë, e qe tek katalogët e prodhuesit nuk paraqiten në mënyrë të njëpasnjëshme. Gjithashtu në katalogët e ofertuar OE nuk ka nënvizuar se produktet e ofruara janë nga materiali Stainless steel or Titanium, dhe se nuk dihet se a vjen produkti Stainless Steel apo Titanium. Duke i analizuar këto fakte konsiderojmë që oferta juaj nuk është i përgjegjshëm dhe nuk e keni plotësuar këtë kriter të DT-së.

Gjate vlerësimit komisioni i ka verifikuar produktet e ofruara nga ana juaj dhe asnjeri nga artikujt ne linkun e websitit te dorëzuar ne broshure, nuk ekzistojnë fare te faqen e internetit te këtij prodhuesi, për dëshmi bashkangjitur këtij vendimi gjeni disa prej artikujve nga katalogu/broshura juaj, të cilat janë kërkuar në website e nuk janë gjetur fare.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Atom Med O.P
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku

Zyrtar përgjegjës i Prokurimit